



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljetno/Prodato Received/Delivery	30-06	2023	3	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHICK	4993	2023	115	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.749/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.749/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 30.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.749/2023 e datës 17.05.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet "Vërejtja" me numër protokolli 545-2 e datës 20.04.2023 e nxjerrë nga Zëvendës Drejtoresha e Departamentit për Reformën e Administratës Publike.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit sipas shkresave të lëndës i punësuar në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Monitorim dhe Zbatim të Reformave" në Departamentin për Reformën e Administratës Publike dhe Integriteteve Evropiane në Ministrinë e Administratës Publike, më datën 20.04.2023 me numër protokolli 545-2 Zv. Drejtoresha e Departamentit për Reformën e Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme i ka i shqyrtuar masën disiplinore Vërejtje.

Kundër masës disiplinore "Vërejtje" e datës 20.04.2023 me numër protokoll 545-2, të Zv. Drejtoreshës së Departamentit për Reformën e Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 17.05.2023, me numër protokoll 4313/2023 me pretendimin ankimor se konstatimet e dhëna nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë janë të paqëndrueshme nuk janë të mbështetura në dispozita ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të parimeve të shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 08.06.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokoll 4313/2023 të datës 17.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me të gjitha shkresat e bashkangjitura; Vërejtja e Zv. Drejtoreshës së Departamentit për Reformën e Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme me numër protokoll 545-2 e datës 20.04.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 08.06.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi në bazë të akt emërimit të datës 05.06.2019, është i punësuar në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Monitorim dhe Zbatim të Reformave" në Departamentin për Reformën e Administratës Publike dhe Integriteteve Evropiane në Ministrinë e Administratës Publike, ndërsa me datë 20.04.2023 me nr. protokoll 545-2 Zv. Drejtoresha e Departamentit për Reformën e Administratës Publike në Ministrinë e Punëve i ka shqiptuar masë disiplinore duke u bazuar në nenin 48 paragrafin 1, nenin 46 paragrafin 1, 2 nën paragrafin 2.2 dhe paragrafin 4, nën paragrafin 4.2, 4.3 dhe nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik me arsyetimin se: *Ju në vazhdimësi refuzoni zbatimin e detyrave në vendin e punës dhe bëni veprime jo të duhura dhe jo në frymën e parimit të shërbimit civil, ku edhe përkundër paralajmërimeve, vërejtjeve gojore dhe vërejtjeve përmes postës elektronike vazhdoni duke thyer rregullat si në vijim: Vazhdoni të mos respektoni nivelin e hierarkisë duke mos më njoftuar për punët që është i përfshirë as në e-mail dhe shkresa të rëndësishme për departamentin dhe në mënyrë vetjake vazhdon punën ndarazi pa më njoftuar; Nuk respektoni orarin e punës dhe nuk më njoftoni për lëvizjet e juaja brenda orarit ku në shumicën e kohës nuk jeni prezent në vendin e punës; Ka raste ku me qëllim shpërndani dezinformata dhe dëmtoni integritetin e punëtorëve duke sajuar gënjeshtër dhe situata të cilat janë duke krijuar atmosferë negative për punën ekipore; Për shkak të detyrave që i kam deleguar, në formë refuzimi keni kërkuar pushim vjetor, i cili është refuzuar për shkak të detyrave që u janë deleguar dhe menjëherë pas kësaj në po të njëjtat data jeni futur në pushim mjekësor me qëllim që t'i ikni obligimeve të zbatimit të detyrave të punës që ju janë dhënë nga ana ime si udhëheqëse e drejtpërdrejtë.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të goditur përmes kësaj ankese, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik, nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Procedura disiplinore përfshin procedurën administrative, që kryhet nga marrja në dijeni për një shkelje disiplinore, deri në marrjen e një mase disiplinore nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt apo Komisioni Disiplinor.”* si dhe nenin 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, ose”* ndërlidhur me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjtit ligj që përcakton sikurse: *“Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: “akti administrativ individual”, gjegjësisht “kolektiv”), dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se nxjerrja e akteve administrative nga institucionin punëdhënës që prodhon efekte juridike për palën sikurse në rastin konkret masa e shqiptuar disiplinore ndaj ankuesit, duhet të bëhet në pajtueshmëri të plotë me dispozitat Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës arrihet në konstatimin se masa e shqiptuar disiplinore ndaj ankuesit, gjegjësisht *“vërejtja”* e datës 20.04.2023 me nr. protokollit 545-2 e shqiptuar nga Zv. Drejtoresha e Departamentit për Reformën e Administratës Publike në Ministrinë e Punëve është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.4 si dhe nenit 48 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse përcaktohet se: *“47. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1 Pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. Pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit, 1.4. Pjesën përmblyëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblyëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë; 48.1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsytet pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.”* për shkak se shkresa e datës 18.04.2023 përmes së cilës është shqiptuar masa disiplinore, nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ, gjegjësisht e njëjta titullohet *“Listë Distribumi”*, shkresë kjo apo format zyrtar i cili përdoret për korrespondencë të brendshme institucionale apo ndërinstitutionale, po ashtu përveç emrit të ankuesit përmban edhe të dhëna të zyrtarëve të tjerë të institucionit, sikurse kjo shkresë nuk përmban pjesën e vendosjes apo dispozitivit sikurse të njëjtës i mungon këshilla juridike, ndërsa arsyetimi i dhënë është dukshëm i pamjaftueshëm ngase nuk është specifik, e që në rastin konkret që të gjitha këto lëshime janë obligative të eliminohen në kuptim të dispozitave të LPPA-së.

Po ashtu, me rastin e dërgimit të kërkesës për përgjigje në ankesën e ankesës e ankuesit, Këshilli përmes e-mailit të datës 29.05.2023 e kishte njoftuar Ministrinë e Punëve të Brendshme me pretendimet ankimore të ankuesit duke e bashkangjitur edhe ankesën e datës 17.05.2023 me numër protokolli:4313/2023, me njoftimin se mund të përgjigjeni në pretendimet e palës, ndërsa në përgjigjen e pranuar të datës 07.06.2023 me shifër:853 Ministria e Punëve të Brendshme, nuk ka arritur të artikuloj apo t'i kundërshtoj në formë të shkruar pretendimet e palës ankuese sikurse i njëjti i ka mbështetur me prova të katër (4) pikat mbi të cilat ishte mbështetur nxjerrja e vërejtjes, sikurse *"1. Vazhdoni të mos respektoni nivelin e hierarkisë duke mos më njoftuar për punët që është i përfshirë as në e-mail dhe shkresa të rëndësishme për departamentin dhe në mënyrë vetjake vazhdon punën ndarazi pa më njoftuar; 2. Nuk respektoni orarin e punës dhe nuk më njoftoni për lëvizjet e juaja brenda orarit ku në shumicën e kohës nuk jeni prezent në vendin e punës; 3. Ka raste ku me qëllim shpërndani dezinformata dhe dëmtoni integritetin e punëtorëve duke sajuar gënjeshtër dhe situata të cilat janë duke krijuar atmosferë negative për punën ekipore; 4. Për shkak të detyrave që i kam deleguar, në formë refuzimi keni kërkuar pushim vjetor, i cili është refuzuar për shkak të detyrave që u janë deleguar dhe menjëherë pas kësaj në po të njëjtat data jeni futur në pushim mjekësor me qëllim që t'i ikni obligimeve të zbatimit të detyrave të punës që ju janë dhënë nga ana ime si udhëheqëse e drejtpërdrejt."*, ndërsa institucioni punëdhënës përveç dërgimit të provave të kërkuara mbi të cilat është mbështetur nxjerrja e masës disiplinore nuk ka dhënë sqarime apo nuk i ka kundërshtuar pretendimet e palës.


Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore ankuesit, shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë dhe analizimit të dispozitave të aplikuara ligjore ka ardhur në përfundimin se masa disiplinore "vërejte" e shqiptuar përmes shkresës së datës 18.04.2023 nga Zv. Drejtoresha e Departamentit për Reformën e Administratës Publike, është akt administrativ i paligjshëm sikurse edhe përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ"* pasi që është konstatuar se e njëjta shkresë apo akt nuk përmban asnjërin nga elementet e detyrueshme të aktit administrativ ndërsa arsytimi i dhënë është i pamjaftueshëm, sikurse arsyet e dhëna në shqiptimin e kësaj mase institucioni punëdhënës nuk i ka kundërshtuar përmes përgjigjes së datës 07.06.2023, dhe si rrjedhojë masa e shqiptuar disiplinore është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, Ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore detyrohet që masën e shqiptuar ta largojë nga dosja e nëpunësit civil.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.Nr.749/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës

  
Eshref Shabani  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.